FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2019 – Numri: 28

Tiranë – E mërkurë, 6 mars 2019

PËRMBAJTJA

		Faqe
Ligj nr. 111/2018 datë 7.2.2019	Për kadastrën.....	1025
Dekret i Presidentit nr.11133, datë 4.3.2019	Për shpalljen e procedurës së aplikimit për plotësimin e vendit vakant gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë.....	1044
Urdhër i ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 118, datë 28.2.2019	Për caktimin e fushës së veprimtarisë dhe detyrave të zëvendësministrit në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë.....	1047

LIGJ
Nr. 111/2018

PËR KADASTRËN

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti i ligjit

Ky ligj rregullon shërbimin publik të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, organizimin e institucionit përgjegjës për këtë shërbim dhe mënyrën e administrimit të kadastrës, si regjistër publik i pasurive të paluajtshme.

Neni 2
Fusha e veprimit

Në këtë ligj përcaktohen rregulla për:

a) organizimin e regjimit kadastral të shtetit;

b) regjistrimin e pronave të paluajtshme private, shtetërore dhe publike, të të drejtave reale mbi to;

c) përmirësimin/përditësimin e regjistrit të pasurive të paluajtshme;

ç) krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës.

Neni 3
Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. "Aktet kadastrale" janë dokumentet zyrtare unike që Agjencia Shtetërore e Kadastrës lëshon për çdo pronar të pasurive të paluajtshme ose titullar të të drejtave reale mbi to. Këto akte përfshijnë: certifikatat, vërtetimet, ekstrakte të kartelës kadastrale, hartës kadastrale dhe akte të tjera të parashikuara në këtë ligj.

2. "Agjenci" ose "ASHK" është Agjencia Shtetërore e Kadastrës, që krijohet dhe funksionon sipas këtij ligji.

3. "Gabime" janë të gjitha pasaktësitë që vijnë si rezultat hedhjes së gabuar të të dhënave në regjistrat apo hartat kadastrale. Gabimi konstatohet nga krahasimi i dokumenteve origjinale me dokumentin e prodhuar nga agjencia ose pas verifikimit fizik të pasurisë.

4. "Hartë kadastrale" është harta shkresore dhe digjitale, në të cilën pasqyrohen kufijtë, përmasat, pozicioni gjeografik, në përputhje me rregullat dhe standardet zyrtare për pasuritë e paluajtshme, si dhe tregues të tjerë.

5. "Kadastër", "regjistër kadastral" ose "regjistër i pasurive të paluajtshme" është regjistri publik, manual dhe digjital, i përbërë nga bashkësia e kartelave dhe hartave kadastrale, ku shënohen të dhëna mbi pronësinë, të drejtat reale, pozicionin gjeografik, përmasat dhe vlerën monetare për pasuritë e paluajtshme.

6. "Kartela" janë fletët e regjistrit manual dhe skedat digjitale, që mbahen për çdo pasuri të paluajtshme.

7. "Pasuri e paluajtshme" ose "pasuri" është çdo send i paluajtshëm, sipas kuptimit të Kodit Civil, si toka, burimet e rrjedhjet e ujërave, drurët, ndërtesat, ndërtimet e tjera notuese të lidhura me tokën dhe çdo gjë që është e trupëzuar në mënyrë të qëndrueshme e të vazhdueshme me tokën ose ndërtesën.

8. "Pasuri e paluajtshme private" është sendi i paluajtshëm në pronësi të personit fizik ose të personit juridik privat.

9. "Pasuri e paluajtshme shtetërore" është sendi i paluajtshëm në pronësi të pushtetit qendror ose të njësisë së vetëqeverisjes vendore.

10. "Pasuri e paluajtshme publike" është sendi i paluajtshëm në pronësi të shtetit, që përmbush funksione themelore dhe të pandashme të shtetit dhe që sjell përfitime në favor të publikut të gjerë.

11. "Të dhëna kadastrale" janë të dhëna të titujve të pronësisë, apo të të drejtave reale, të përmasave dhe vendndodhjes gjeografike të pasurisë, si dhe të vlerës monetare që ajo ka në momentin e krijimit të saj dhe në vijim.

12. "Regjistrim fillestar" është procedura e regjistrimit për herë të parë të pasurive të paluajtshme në kartela dhe në hartë kadastrale.

13. "Veprimtari kadastrale" është tërësia e akteve dhe e veprimeve administrative, në bazë

të këtij ligji, që kryhet nga ana e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, për regjistrimin e përditësimin e të dhënave kadastrale të çdo pasurie, si dhe për lëshimin e akteve kadastrale.

Neni 4
Subjektet

1. Subjekte, në kuptim të këtij ligji, konsiderohen pronarët, titullarët e të drejtave reale mbi pasuritë e paluajtshme, personat fizikë ose juridikë, që kanë interes të ligjshëm mbi pasuritë.

2. Persona me interes të ligjshëm janë personat e tretë, të drejtat e të cilëve kanë të bëjnë me pasurinë për të cilën kërkohen të dhëna (sipas dokumentacionit provues) apo që ushtrojnë funksione publike, për realizimin e të cilave janë të nevojshme këto të dhëna.

3. Pronarëve dhe titullarëve të të drejtave reale mbi pasuritë u ofrohet shërbimi kadastral, duke u mjaftuar me identifikimin e tyre përpara zyrave dhe drejtorive vendore të ASHK-së. Për titujt e regjistruar, institucioni verifikon vetë lidhjen e pronarit me pronën e tij, pa detyruar pronarin të sjellë dokumentacion që i lëshon vetë drejtoria kadastrale.

4. Informacioni bazik mbi hartën kadastrale, adresën e pronës, emrin e pronarit, vendimmarrjet e Këshillit të Ministrave, gjykatave ose të dhëna mbi funksionimin e tregut të pasurive bëhet publik pa kërkesë.

Neni 5
Parime të përgjithshme për shërbimin kadastral

Shërbimi publik i regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe procedurat e lidhura me të udhëhiqen nga këto parime themelore:

a) Parimi i ligjshmërisë, sipas të cilit, veprimtaria kadastrale ushtrohet në përputhje me Kushtetutën, Kodin Civil, këtë ligj dhe me aktet e tjera ligjore.

b) Parimi i sigurisë juridike: respektimi i të drejtave të fituara më parë dhe i pritshmërive të ligjshme të subjekteve të së drejtës.

c) Ekskluziviteti: Veprimtaria kadastrale është shërbim publik unik. Funksionet që i atribuohen ekskluzivisht ASHK-së, sipas këtij ligji, nuk mund të ushtrohen nga institucione të tjera.

ç) Transparenca: veprimtaria kadastrale ushtrohet në transparencë dhe në bashkëpunim të ngushtë me personat fizikë dhe juridikë, palë apo subjekte të interesuara, në çështjet që kanë të bëjnë me pasuritë e paluajtshme.

KREU II
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS

Neni 6
Statusi dhe financimi i Agjencisë Shtetërore të Kadastrës

1. Agjencia Shtetërore e Kadastrës (në vijim ASHK) është person juridik publik në varësi të Kryeministrit, që krijohet me këtë ligj dhe funksionon si institucion me vetëfinancim. Burimet e financimit janë:

a) të ardhurat e krijuara nga vetë Agjencia;

b) buxheti i shtetit;

c) donacionet, financimet e huaja dhe kreditë.

2. Veprimtaria buxhetore dhe financiare e ASHK-së i nënshtrohet legjislacionit përkatës në fuqi në Republikën e Shqipërisë. Buxheti i Agjencisë Shtetërore të Kadastrës miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për financat.

3. Të ardhurat, që do të rezultojnë të papërdorura në fund të vitit financiar, trashëgohen në buxhetin e vitit ushtrimor pasardhës.

4. Si garanci për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga veprimtaria kadastrale, ASHK-ja krijon fondin rezervë vjetor, në masën që përcaktohet nga këshilli drejtues.

Neni 7
Organizimi dhe drejtimi i Agjencisë

1. Agjencia Shtetërore e Kadastrës organizohet në nivel qendror, nëpërmjet Drejtorisë së Përgjithshme në Tiranë, dhe në nivel vendor, në drejtori e zyra, si struktura varësie.

2. Organizimi i brendshëm, struktura dhe organika, si dhe numri i strukturave të varësisë miratohen nga Kryeministri, me propozim të këshillit drejtues.

3. Organet drejtuese të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës janë këshilli drejtues dhe

Drejtori i Përgjithshëm.

Neni 8
Këshilli drejtues

1. Këshilli drejtues ka gjithsej 7 anëtarë. Anëtarët e këshillit drejtues nuk janë funksionarë me kohë të plotë dhe zgjidhen përkatësisht si përfaqësues nga:

a) Ministria e Drejtësisë;

b) Ministria e Financave;

c) ministria përgjegjëse për bujqësinë;

ç) ministria përgjegjëse për zhvillimin urban;

d) Kryeministria;

dh) autoriteti shtetëror përgjegjës për informacionin gjeohapësinor.

e) një përfaqësues nga ASHK-ja.

Anëtarët duhet të kenë formim profesional të fushave të inxhinierisë, gjeodezisë, drejtësisë, ekonomisë ose administrimit publik, si dhe eksperiencë pune të paktën 5 vjet në organet e administratës shtetërore. Anëtarët e Këshillit drejtues emërohen dhe shkarkohen nga Këshilli i Ministrave. Këshilli drejtues në mbledhjen e tij të parë zgjedh kryetarin.

2. Këshilli i Ministrave përcakton rregullat e funksionimit të këshillit drejtues, si dhe masën e shpërblimit për veprimtarinë e anëtarëve.

3. Kohëzgjatja e detyrës së kryetarit është 2 vjet.

4. Këshilli drejtues kryen këto detyra:

a) miraton projekt-programin buxhetor afatmesëm dhe projekt-programin vjetor të veprimtarisë së vitit të ardhshëm financiar, të cilat ia propozon ministrit përgjegjës për financat, si dhe kontrollon çdo tre muaj drejtimet e përgjithshme të veprimtarisë financiare të Agjencisë;

b) i propozon ministrit përgjegjës për financat miratimin e tarifave të shërbimit të Agjencisë;

c) miraton rregulloren për organizimin dhe administrimin e të dhënave të kadastrës, si dhe të të dhënave të tjera që administron ASHK-ja;

ç) miraton raportin vjetor të veprimtarisë, përfshirë edhe çështjet e auditimit të brendshëm;

d) i paraqet Kryeministrit dhe Ministrit të Drejtësisë raporte për veprimtarinë kadastrale;

dh) miraton ndarjen e zonave të regjistrimit dhe të zonave kadastrale në territorin e Republikës së Shqipërisë;

e) miraton nënshkrimin e marrëveshjeve me persona fizikë, juridikë, publikë apo privatë, organizata jofitimprurëse, me qëllim rritjen apo përmirësimin e shërbimit kadastral;

ë) i paraqet Kryeministrit për miratim strukturën dhe organikën e Agjencisë;

f) i paraqet Kryeministrit nivelin e pagave të punonjësve të Agjencisë, për miratim në Këshillin Ministrave;

g) miraton kriteret dhe nivelin e shpërblimeve të punonjësve të Agjencisë;

gj) miraton masën e fondit rezervë vjetor, që shërben si garanci për mbulimin e dëmshpërblimeve, që rrjedhin sipas përcaktimeve të këtij ligji;

h) miraton rregulloren e brendshme të funksionimit të Agjencisë;

i) miraton drejtimet politike afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata, që lidhen me çështje të përditësimit të informacionit në sistemin elektronik dhe bazën e të dhënave;

j) detyra të tjera të parashikuara në ligj apo në akte nënligjore.

Neni 9
Drejtori i Përgjithshëm

1. Drejtori i Përgjithshëm emërohet dhe shkarkohet nga Kryeministri. Ai zgjidhet nga radhët e profesionistëve të fushave të inxhinierisë, gjeodezisë, drejtësisë, ekonomisë ose administrimit publik, me eksperiencë pune të paktën 5 vjet në organet e administratës shtetërore.

2. Drejtori i Përgjithshëm, në përputhje me kompetencat e përcaktuara në këtë ligj dhe në ligje të tjera të posaçme, kryen këto detyra:

a) drejton aktivitetin e Agjencisë në fushat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të zbatimit të legjislacionit për çështjet e pronësisë, sipas objektivave politikë të Këshillit të Ministrave, planeve strategjike dhe programeve të performancës;

b) harton projekt-programin buxhetor afatmesëm dhe projekt-programin vjetor të veprimtarisë të vitit të ardhshëm financiar;

c) harton programe dhe miraton urdhra e udhëzime për funksionimin, zhvillimin,

përmirësimin dhe rritjen e cilësisë së shërbimeve kadastrale dhe të aktivitetit në zbatim të legjislacionit për çështjet e pronësisë;

ç) emëron dhe liron personelin e Agjencisë, përfshirë dhe drejtuesit e drejtorive dhe zyrave në nivel vendor;

d) i propozon këshillit drejtues ndërmarrjen e nismës për rishikimin apo ndryshimin e tarifave të shërbimeve të ofruara nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës, me qëllim mbulimin e kostove të shërbimit dhe menaxhimin me efiçencë të të ardhurave;

dh) ushtron kontroll mbi veprimtarinë e drejtorive dhe zyrave në nivel vendor, duke përfshirë edhe auditimin, sipas legjislacionit përkatës;

e) përcakton kriteret e veçanta që duhet të plotësohen nga personeli i Agjencisë, rregullat për testimin e aftësive profesionale, si dhe planet për trajnimin e burimeve njerëzore;

ë) përgatit dhe paraqet në këshillin drejtues raportin vjetor financiar, raportin vjetor për veprimtarinë e institucionit, si dhe raporte periodike, me kërkesë të këshillit;

f) i paraqet këshillit drejtues strukturën, organikën dhe nivelin e pagave të punonjësve të Agjencisë;

g) i paraqet këshillit drejtues për miratim kriteret dhe nivelet e shpërblimit të punonjësve;

gj) miraton, rast pas rasti, shpërblimin e punonjësve sipas kritereve dhe niveleve të përcaktuara nga këshilli drejtues;

h) përfaqëson ligjërisht Agjencinë në marrëdhënie me të tretët;

i) harton dhe propozon rregulloret që miratohen nga këshilli drejtues;

j) harton dhe i paraqet Kryeministrit projektaktet që propozohen për shqyrtim në Këshillin e Ministrave me karakter individual dhe normativ;

k) përgatit dhe i paraqet Kryeministrit projektvendimin e Këshillit të Ministrave "Për miratimin e hartës së vlerës së tokës", që përmban çmimet e referencës së tokës në Republikën e Shqipërisë. Metodologjia e llogaritjes së këtyre çmimeve përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave;

l) detyra të tjera të parashikuara në ligj apo në akte nënligjore.

3. Drejtori i Përgjithshëm mbështetet në veprimtarinë e tij nga zëvendësdrejtorët e përgjithshëm, një prej të cilëve është drejtues i strukturës përgjegjëse për ankimin administrativ. Zëvendësdrejtorët e përgjithshëm emërohen nga këshilli drejtues, me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm.

Neni 10

Strukturat e varësisë

1. Drejtoritë vendore të Agjencisë administrojnë kadastrën e zonës/zonave të regjistrimit në kompetencë të tyre, si dhe janë përgjegjëse për zbatimin e procedurave të parashikuara në legjislacionin për çështjet e pronësisë.

2. Zyrat vendore janë struktura në varësi të drejtorive vendore dhe ngrihen pranë njësive administrative territoriale. Këto zyra kryejnë shërbimet e drejtpërdrejta ndaj publikut dhe ndaj subjekteve të interesuara.

3. Drejtoria vendore administron:

a) kadastrën (regjistrin e pasurive të paluajtshme);

b) hartat kadastrale për zonën e regjistrimit të pasurive të paluajtshme;

c) vendimet gjyqësore, aktet administrative, kontratat, aktet dhe dokumentet e tjera, të hartuara sipas ligjit, që kanë ndikim mbi regjimin juridik të pasurisë së paluajtshme apo të të drejtave reale mbi to, të cilat, sipas ligjit, duhet të regjistrohen në regjistrat e pasurive të paluajtshme;

ç) plane rilevimi, indekse të regjistrimeve në regjistrat e pasurive të paluajtshme, si dhe regjistra të tjerë, të krijuar apo të administruar gjatë veprimtarisë së zyrave vendore të pasurive të paluajtshme;

d) informacion filmik dhe elektronik;

dh) dokumentacionin për procedurat administrative, të parashikuara në legjislacionin për çështjet e pronësisë.

4. Drejtoria vendore drejtohet nga drejtori vendor, që emërohet dhe shkarkohet nga Drejtori i Përgjithshëm nga radhët e profesionistëve të fushave të inxhinierisë, gjeodezisë, drejtësisë, ekonomisë ose administrimit publik, me eksperiencë pune të paktën 3 vjet në organet e administratës shtetërore.

5. Drejtori i drejtorisë vendore është

autoriteti që lëshon akte kadastrale për çdo pasuri që gjendet në juridiksionin territorial të drejtorisë dhe nxjerr aktet në zbatim të legjislacionit për çështjet e pronësisë.

6. Në çdo drejtori vendore emërohet edhe të paktën një zëvendësdrejtor, i cili duhet të plotësojë të njëjtat kritere si drejtori dhe e mbështet atë në kryerjen e funksioneve të tij.

Neni 11
Marrëdhëniet e punës, kriteret, statusi dhe rekrutimi i punonjësve

1. Marrëdhëniet e punës së punonjësve të ASHK-së rregullohen sipas dispozitave të Kodit të Punës. Niveli i pagave të punonjësve përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

2. Punonjësit e ASHK-së duhet të përmbushin kriteret e përgjithshme, sipas legjislacionit për shërbimin civil, si dhe kriteret e veçanta të përcaktuara nga Drejtori i Përgjithshëm. Punonjësit përzgjidhen sipas kërkesave të pozicionit specifik të vendit të punës.

3. Kandidatët për t'u punësuar pranë ASHK-së i nënshtrohen procedurës së konkurrimit.

Neni 12
Hierarkia administrative e akteve kadastrale

1. Drejtori i drejtorisë vendore përgjigjet para Drejtorit të Përgjithshëm për të gjithë veprimtarinë e drejtorisë vendore.

2. Aktet e drejtorit të varësisë i nënshtrohen kontrollit administrativ nga:

a) struktura përgjegjëse për ankimet administrative, gjatë shqyrtimit të tyre;

b) Drejtori i Përgjithshëm, kryesisht, nëpërmjet strukturës së auditit të brendshëm.

3. Drejtori i Përgjithshëm ose struktura përgjegjëse për ankimet, kur konstatojnë se akti administrativ është i paligjshëm ose i parregullt, sipas rastit:

a) shfuqizon, anulon ose konstaton pavlefshmërinë e aktit administrativ të paligjshëm, sipas parashikimeve të Kodit të Procedurës Administrative;

b) udhëzon drejtorinë e varësisë për të korrigjuar gabimet materiale në akt.

KREU III
SISTEMI KADASTRAL

Neni 13
Të dhënat kadastrale

1. Çdo pasuri e paluajtshme regjistrohet në kadastër, duke u pasqyruar në kartelën përkatëse të pasurisë dhe në hartën kadastrale.

2. Kartelat dhe hartat që përbëjnë kadastrën administrohen në format shkresor dhe digjital.

3. Kartela e pasurisë mban detyrimisht të dhëna për:

a) pozicionin gjeografik të pasurisë;

b) sipërfaqen e pasurisë;

c) llojin e pasurisë së paluajtshme (ndërtesë, truall, arë, kullotë etj.);

ç) identifikimin e pronarit të pasurisë;

d) aktin nga i cili ka lindur titulli i pronësisë mbi pasurinë;

dh) të drejtat e të tretëve mbi pasurinë dhe aktet prej të cilave ato burojnë;

e) vlerën e pasurisë;

ë) çdo akt tjetër që ndryshon regjimin juridik të pronës, apo krijon të drejta apo detyrime mbi pasurinë;

f) të dhëna të tjera që përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

4. Dokumentacioni për të drejtat dhe të dhënat e tjera mbi pasurinë, mbi bazën e të cilit plotësohet kartela, ruhet dhe arkivohet në drejtorinë vendore.

5. Modeli i kartelës së pasurisë së paluajtshme përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

6. Kadastra në format digjital përbën bazën shtetërore të të dhënave mbi pasuritë e paluajtshme. Ministria e Drejtësisë ka akses në këtë bazë të dhënash, në rolin e mbikëqyrësit të saj.

Rregullat e hollësishme për përdorimin, administrimin dhe ruajtjen e bazës së të dhënave mbi pasuritë e paluajtshme përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, në përputhje me kërkesat e legjislacionit për bazat e të dhënave shtetërore.

Neni 14
Zona e regjistrimit dhe zona kadastrale

1. Për efekt të regjistrimit të pasurive,

territori i Republikës së Shqipërisë ndahet në zona kadastrale. Zona kadastrale është njësia bazë e krijimit dhe mbajtjes të të dhënave kadastrale. Për miradministrimin e këtyre të dhënave, pasuritë brenda zonës kadastrale grupohen në blloqe.

2. Bashkësia e një sërë zonash kadastrale me vijimësi territoriale përbën zonën e regjistrimit.

3. Drejtoria vendore kadastrale përfshin një grup zonash regjistrimi.

4. Agjencia Shtetërore e Kadastrës administron tërësinë e zonave kadastrale në një sistem identifikimi unik.

Neni 15
Harta kadastrale

1. Të dhënat mbi pozicionin, përmasat dhe konfigurimin e pronave të paluajtshme të zonës kadastrale pasqyrohen nga drejtoria vendore në hartën kadastrale.

2. Harta kadastrale krijohet në momentin e regjistrimit fillestar të pasurive të zonës kadastrale dhe në vijim përditësohet nga zyra vendore.

3. Harta kadastrale duhet të tregojë detyrimisht:

a) kufijtë dhe pozicionin gjeografik të çdo pasurie;

b) numrin unik identifikues të çdo pasurie brenda numrit të zonës kadastrale;

c) të dhëna të tjera teknike që vendosen sipas përcaktimeve të Këshillit të Ministrave.

Këto të dhëna mbështeten në dokumentet ligjore, me të cilat janë krijuar marrëdhëniet e pronësisë dhe janë pjesë e certifikatës së pronësisë.

4. Përmbledhja e të gjitha hartave kadastrale përbën hartën unike kombëtare të pronave të Republikës së Shqipërisë.

5. Agjencia kombëtare ka për detyrë të krijojë harta kadastrale specifike për gjithë territorin. Harta specifike kadastrale përgatitet sipas nevojës së shtetit për informacion kadastral të integruar.

Neni 16
Korrigjimi i gabimeve në të dhënat kadastrale

1. Gabimet që vijnë nga veprimtaria e drejtorisë vendore korrigjohen pas konstatimit që bën drejtori vendor ose Drejtori i Përgjithshëm kryesisht, struktura përgjegjëse për ankimet ose me kërkesë të personave të interesuar.

2. Drejtoria kadastrale është e detyruar të korrigjojë gabimet në pasqyrimin e të dhënave në kartelë dhe në hartën kadastrale, në raport me dokumentacionin e pronësisë apo me gjendjen faktike të pasurisë.

3. Korrigjimi i gabimit është shërbim që nuk tarifohet.

4. Kur gabimi konstatohet në hartat kadastrale, drejtori i zyrës mund të urdhërojë riverifikimin në terren.

5. Refuzimi për të korrigjuar gabimet e saj e bën përgjegjëse drejtorinë vendore, sipas parashikimeve të këtij ligji.

6. Agjencia nuk mban përgjegjësi për gabimet e akteve noteriale të lidhura ndërmjet subjekteve private.

Neni 17
Certifikatat

1. Drejtoria vendore, në përfundim të regjistrimit fillestar ose pas regjistrimit të çdo kalimi pronësie nga një pronar te një tjetër, lëshon certifikatën e pronësisë.

2. Certifikata e pronësisë është dokumenti unik i papërsëritshëm që provon titullin e pronësisë, statusin ligjor dhe kufijtë e pronës.

3. Certifikata e pronësisë i lëshohet vetëm personit pronar ose bashkëpronarëve. Në rastin e bashkëpronësisë certifikata hartohet në aq kopje sa është numri i bashkëpronarëve.

4. Certifikata e pronësisë shoqërohet gjithnjë me kopje të kartelës kadastrale dhe hartës përkatëse kadastrale. Pas çdo ndryshimi të pronësisë mbi pasurinë, bashkimi apo ndarjeje të saj, lëshohet certifikatë, kartelë dhe hartë e re, sipas gjendjes së përditësuar.

5. Certifikata e pronësinë, bashkëpronësisë lëshohet mbi bazën e një dokumenti ligjor origjinal që përcakton krijimin e këtyre të drejtave. Një certifikatë e lëshuar në kundërshtim me këtë parashikim konsiderohet absolutisht e pavlefshme.

6. Lëshohet certifikatë dhe për vërtetimin e të drejtave të tjera reale mbi pasurinë e

paluajtshme, si: qiraja, enfiteoza, përdorimi, uzufrukti, servituti, hipoteka etj.

7. Modeli i certifikatës së pronësisë dhe i certifikatave për të drejtat e tjera reale mbi pasurinë miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave. Certifikatat që lëshohen jashtë modelit të miratuar nuk kanë asnjë vlerë ligjore.

Neni 18
Certifikatat e humbura

1. Pronarit, bashkëpronarit apo titullarit të së drejtës reale të një prone mund t'i lëshohet një certifikatë "Dublikatë" vetëm kur origjinalja humbet ose është dëmtuar në mënyrë të palexueshme.

2. Në këto raste pronari/bashkëpronari ose titullari i së drejtës reale duhet të paraqesë një kërkesë ku të tregojë faktin e humbjes së certifikatës origjinale ose të tregojë certifikatën e dëmtuar.

3. Drejtoria vendore publikon njoftim për certifikatën e humbur apo të dëmtuar, për 15 ditë. Vetëm pas kalimit të këtij afati mund të lëshohet certifikata e re.

Neni 19
Akte të tjera kadastrale

1. Drejtoria vendore lëshon edhe akte të tjera kadastrale, sipas gjendjes ligjore të pasurisë apo shërbimit që ofron, sipas këtij ligji.

2. Vërtetimi i pronësisë është akti zyrtar që lëshohet për të provuar se pronari ka depozituar dokumentet ligjore për regjistrim, por prona ndodhet në një zonë kadastrale që nuk i është nënshtruar ende regjistrimit fillestar.

3. Ekstrakti mbi gjendjen e pasurisë lëshohet sipas kërkesës së pronarit, noterit apo personit të ngarkuar në funksion të kryerjes së një veprimi juridiko-civil.

4. Harta kadastrale lëshohet me kërkesë të pronarit, personit të interesuar, noterit dhe gjykatës.

5. Vërtetimi i regjistrimit lëshohet për çdo regjistrim në regjistra të veçantë, si regjistri i lejeve të ndërtimit, i prokurave e kontratës së qirave, si dhe rasteve të veçanta që parashikohen në këtë ligj.

6. Formulari i aplikimit, i dorëzuar rregullisht në zyrën kadastrale, provon lindjen e marrëdhënies ligjore të kërkuesit të shërbimit me zyrën. Marrja në dorëzim e formularit vërtetohet gjithnjë nga zyra kadastrale.

Neni 20
Përditësimi i informacionit kadastral

1. Të dhënat kadastrale përditësohen rregullisht me kërkesë të pronarit ose personit të interesuar nga vetë drejtoria vendore ose me urdhër të Drejtorisë së Përgjithshme të ASHK-së.

2. Të dhënat kadastrale përditësohen sa herë që mbi pronë ndodh një transaksion.

3. Agjencia ka për detyrë të ndërtojë një sistem periodik të përditësimit të të dhënave kadastrale, të cilat duhen reflektuar në çdo hartë e kartelë kadastrale. Përditësimi lidhet me:

a) ndryshimin e vlerës së pronës, sipas tregut;

b) ndryshimet natyrore;

c) ndërhyrjet në infrastrukturë dhe ndërtime;

ç) regjistrimin fillestar të zonave kadastrale;

d) rrethana apo ngjarje të tjera që janë të ndërvarura nga procese të tjera, por që urdhërohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

4. Përditësimi i informacionit kadastral si proces përfshin:

a) rifreskimin e dokumentacionit ligjor, kur është rasti i shqyrtimit të kërkesave të pronarëve, personave të interesuar apo zbatimin e vendimeve të gjykatave;

b) rifreskimin e hartës kadastrale me ndryshime që kanë ndodhur në terren. Në këtë rast zyra kadastrale detyrimisht verifikon vetë fizikisht ndryshimet e ndodhura dhe bën rifreskim pa ndryshuar kufijtë e pronave të tjera;

c) rifreskimin e vlerës së pronës në çdo zonë kadastrale, duke shënuar vlerën e re sa herë që ajo vendoset nga Këshilli i Ministrave;

ç) rifreskimin e adresave të pronarëve që lidhen me pronat e tyre.

Neni 21
Bashkimet dhe ndarjet e dokumenteve mbi pronat kufitare me pronar të njëjtë

1. Nëse pasuritë e paluajtshme në kufij të ngjitur me njëra-tjetrën (qoftë në plan apo në lartësi), janë pronë e të njëjtit pronar, si dhe i

nënshtrohen në çdo rast të drejtave dhe detyrimeve të njëjta, me kërkesë të pronarit, drejtoria vendore regjistron bashkimin e tyre, duke mbyllur kartelat që u takojnë këtyre pasurive të paluajtshme dhe duke hapur një kartelë të vetme.

2. Me kërkesën me shkrim të pronarit të vetëm apo të të gjithë bashkëpronarëve për ndarjen e një pasurie të paluajtshme në dy a më shumë pjesë të kësaj pasurie, drejtoria vendore bën regjistrimin e ndarjes, duke mbyllur kartelën për pasurinë e paluajtshme që ndahet, hap kartela të reja dhe përditëson hartat kadastrale për pasuritë e paluajtshme të reja, që dalin nga ndarja dhe regjistron në kartelat e reja të gjithë informacionin që kishte kartela e mbyllur.

3. Në asnjë rast nuk lejohet ndryshimi i pronësisë së pasurisë së paluajtshme, që fshin të drejtat reale mbi të. Kur një pronar dëshiron ta ndajë në pjesë pasurinë e paluajtshme të tij, duhet të përgatitet një plan i ri rilevimi të nënndarjeve të propozuara.

4. Në të gjitha rastet e përcaktuara në pikat e mësipërme të këtij neni, pronarët dorëzojnë pranë drejtorisë vendore certifikatën origjinale të pasurisë që do të bashkohet ose do të ndahet, si dhe pajisen me certifikata të reja pronësie për pasuritë e krijuara.

KREU IV
PROCESI I REGJISTRIMIT TË TITUJVE

Neni 22
Regjistrimi i titujve të pronësisë

1. Për çdo zonë kadastrale drejtoria vendore mban një regjistër kadastral ku shënon të dhëna të ekstraktuara nga dokumentet e pronësisë të të gjithë pronarëve të zonës kadastrale.

2. Regjistri kombëtar kadastral krijohet dhe administrohet nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës.

3. Ministria e Drejtësisë mbikëqyr veprimtarinë e regjistrit të pasurive të paluajtshme, sipas parashikimeve të këtij ligji.

Neni 23
Pasojat juridike të regjistrimit

1. Drejtoria vendore kadastrale regjistron:

a) titujt që ajo krijon nga veprimtaria në zbatim të legjislacionit për çështjet e pronësisë;

b) titujt që krijohen nga veprimet juridiko-civile ndërmjet subjekteve të së drejtës private, nga vendimet gjyqësore, apo nga akte të organeve të tjera publike.

2. Drejtoria vendore, me aktin e regjistrimit dhe lëshimin e certifikatës, garanton formalisht titullin e pronësisë në favor të pronarit ose bashkëpronarëve. Më lëshimin e certifikatës, pronarit i lind e drejta për ta disponuar pronën lirisht, për aq sa ajo nuk ka barrë hipotekore.

3. Drejtoria vendore mund të ndryshojë përmbajtjen e regjistrit vetëm në rastet e mëposhtme:

a) me paraqitjen e një dokumenti noterial që konfirmon vullnetin e pronarit, në përputhje me dispozitat e Kodit Civil dhe të legjislacionit në fuqi;

b) sipas përmbajtjes së vendimit gjyqësor;

c) kur është e nevojshme, në përputhje me procedurat dhe kriteret e përcaktuara në legjislacionin për çështjet e pronësisë;

ç) për korrigjimin e pasaktësive hartografike dhe gabimeve materiale;

d) për përmirësim-përditësimin e regjistrit;

dh) sipas një akti tjetër ligjor të detyrueshëm për regjistrim, sipas Kodit Civil dhe legjislacionit në fuqi.

Neni 24
Regjistrimi i detyruar dhe njoftimi i akteve

1. Çdo akt që sjell ndryshime dhe ose përfitim të së drejtës së pronësisë, sipas parashikimeve të Kodit Civil, duhet të regjistrohet.

2. Aktet e gjykatave, noterëve, përmbaruesve gjyqësorë dhe organeve të tjera shtetërore, që përmbajnë fitimin, njohjen, ndryshimin, pushimin e një të drejte pronësie, ose që deklarojnë të pavlefshme veprimet juridike ose aktet e tjera për kalimin e pronësisë të regjistruar më parë, duhet të regjistrohen.

Organet i deklarojnë aktet e sipërpërmendura në kadastrën digjitale kombëtare, që në momentin e formalizimit të tyre, nëpërmjet aksesit të siguruar nga ASHK-ja.

3. Krahas deklarimit në rrugë elektronike, organet e sipërpërmendura dërgojnë pranë drejtorisë vendore të ASHK-së kopje shkresore të këtyre akteve, brenda 10 ditëve nga data e formalizimit të tyre.

4. Të gjitha aktet e parashikuara në këtë nen i nënshtrohen regjistrimit paraprak në kadastër. Çdo akt apo veprim i mëvonshëm tjetërsimi i pasurisë, që nuk ka vijimësi kronologjike dhe që do të krijonte mbivendosje të titujve, refuzohet nga ASHK-ja.

5. Regjistrimi përfundimtar i akteve realizohet me kërkesë të palës së interesuar/përfituese të të drejtave, pas pagesës së tarifës së shërbimit. Vetëm pas shlyerjes së saj, subjekti përfiton certifikatën e pronësisë dhe shërbimet e tjera kadastrale si pronar i pasurisë apo titullar i të drejtave të tjera reale.

Neni 25
Kërkesa për regjistrim dhe kamatëvonesa

1. Çdo person, mbajtës i titullit të pronësisë apo i një të drejte reale, të detyrueshme për regjistrim, sipas dispozitave të Kodit Civil, apo të ligjit të veçantë, duhet të paraqesë kërkesë për regjistrimin e titullit, brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi të tij.

2. Nëse kërkesa për regjistrim paraqitet tej afatit 30-ditor, kërkuesi, përveç tarifës së regjistrimit, për çdo ditë vonesë, duhet të paguajë edhe kamatëvonesë, të barabartë me 10 % e tarifës së regjistrimit, por jo më shumë se 300 000 lekë.

3. Përjashtimisht, për regjistrimin e pasurive që trajtohen nga legjislacioni për çështjet e pronësisë, drejtoria vendore zbaton procedura të posaçme, të parashikuara në këtë ligj, legjislacionin përkatës dhe në aktet nënligjore në zbatim të tyre.

Neni 26
Pamundësia për regjistrim

1. Drejtoria vendore, kur konstaton se akti noterial, vendimi i gjykatës apo akti administrativ që përcakton kalimin e pronësisë ose ndryshimin e statutit të saj është i paqartë, pezullon procedurën dhe njofton kërkuesin. Në këtë rast kërkuesit i kërkohet të përcaktojë qartë informacionin e nevojshëm, brenda një afati 30-ditor.

2. Do të konsiderohet informacion i paqartë, për efekt regjistrimi:

a) mungesa e identitetit ose mospërputhje me identitetin në kartelën e pasurisë;

b) mospërcaktimi i pronës në kufij, sipërfaqe dhe në pozicion gjeografik të saktë.

3. Në rast se pronari nuk arrin të saktësojë këtë informacion, drejtoria vendore e ASHK-së, me urdhër të drejtorit, refuzon regjistrimin.

Neni 27
Vendosja e kufizimeve të përkohshme

1. Përveç sa parashikohet në dispozita të veçanta në këtë ligj, drejtuesi i drejtorisë vendore kadastrale ose Drejtori i Përgjithshëm mund të urdhërojnë ndalimin e veprimeve në çdo kartelë, hartë apo zonë kadastrale, vetëm në këto raste:

a) për të parandaluar një mashtrim ose veprim të padrejtë, që ka për qëllim kalimin e pronësisë në mënyrë të paligjshme;

b) kur e kërkojnë strukturat e kontrollit ose të trajtimit të ankimeve të Drejtorisë së Përgjithshme, për arsye të evidentimit të veprimeve të paligjshme mbi pasuritë.

2. Urdhri lëshohet me shkrim edhe pa kërkesën e personit të interesuar dhe i njoftohet nëpunësit që administron praktikën përkatëse.

3. Urdhri i ndalimit të veprimeve kadastrale, në çdo rast, zgjat 30 ditë kalendarike nga dita e lëshimit të tij. Pas këtij afati ai e humbet fuqinë e tij, nëse nuk është vendosur sigurimi i padisë nga gjykata.

4. Drejtoria vendore kadastrale është e detyruar të njoftojë pronarin për lëshimin e urdhrit të ndalimit të veprimeve. Kundër urdhrit të ndalimit pronari ka të drejtën e ankimit.

Neni 28
Garantimi i aksesit mbi ekstraktet

1. Shpërndarja e ekstrakteve të regjistrit kadastral kryhet duke garantuar sigurinë e sistemit të të dhënave dhe standardet e parimet për mbrojtjen e të dhënave personale, sipas legjislacionit në fuqi, nëpërmjet disa niveleve të sigurisë, të përcaktuara nga udhëzimet e Drejtorisë së Përgjithshme.

2. Personave juridikë/fizikë, vendas apo të huaj, mund t'u jepet kodi i hyrjes dhe e drejta e marrjes së ekstrakteve të të dhënave, në mënyrë të drejtpërdrejtë nga kadastra digjitale, duke garantuar teknikisht pamundësinë e manipulimit të saj nëpërmjet sistemit elektronik. E drejta e hyrjes dhe e marrjes së ekstrakteve sigurohet edhe nëpërmjet portalit unik qeveritar, shumëfunksional.

3. Personat juridikë/fizikë, vendas apo të huaj, që kanë të drejtën për të pasur akses në

sistemin elektronik apo në portalin unik qeveritar shumëfunksional, mund të marrin ekstrakte/dokumente elektronike pronësie në mënyrë të drejtpërdrejtë, pasi kanë marrë pëlqimin e subjekteve, që figurojnë të regjistruar si pronarë të pasurisë së paluajtshme.

4. Subjektet e tjera, që nuk kanë të drejtë aksesi, sipas pikave 2 dhe 3 të këtij neni, kanë të drejtë të kërkojnë nga drejtoria vendore e kadastrës informacionin përkatës, me postë elektronike ose të zakonshme, kundrejt plotësimit të kërkesave të këtij ligji.

5. Drejtoria e Përgjithshme verifikon periodikisht nëse marrja e këtyre të dhënave nga subjektet është bërë në përputhje me përcaktimet e këtij ligji dhe të akteve nënligjore në zbatim.

6. ASHK-ja siguron akses të drejtpërdrejtë në kadastrën digjitale për organet që ushtrojnë ndjekjen penale dhe agjencitë ligjzbatuese. Këshilli i Ministrave miraton me vendim listën e institucioneve që kanë akses në kadastrën digjitale dhe rregullat e marrjes së informacionit.

7. ASHK-ja siguron kushtet për krijimin, regjistrimin, administrimin dhe funksionimin e të dhënave digjitale të pasurive të paluajtshme në sistemin e brendshëm të organizimit dhe ndërveprimit me bazat e tjera të të dhënave shtetërore.

8. Rregullat dhe procedurat për ushtrimin e së drejtës nga personat juridikë/fizikë, vendas apo të huaj, për të pasur akses në sistemin elektronik, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 29
Kërkesa dhe afatet

1. Çdo shërbim kadastral kryhet vetëm pas dorëzimit të një kërkese. Kërkesa është një formular tip që gjendet në sportelet e shërbimit ose *on-line*.

Modeli i kërkesës miratohet nga Drejtoria e Përgjithshme, sipas llojit të shërbimit që kërkohet.

2. Agjencia publikon të gjitha llojet e shërbimeve që kryen kadastra, formularin e kërkesës përkatëse dhe dokumentacionin shoqërues të kërkuar për çdo shërbim. Publikimi duhet të jetë i dukshëm dhe i arritshëm për çdo shtetas.

3. Çdo kërkesë për shërbim kadastral, që paraqitet rregullisht, trajtohet brenda 15 ditëve nga data e depozitimit, por në çdo rast jo më vonë se 21 ditë kalendarike.

4. Këshilli i Ministrave miraton rregullat për procedurën e trajtimit të kërkesave.

KREU V
REGJISTRIMI FILLESTAR

Neni 30
Fillimi i regjistrimit fillestar

1. Regjistrimi fillestar bëhet për një zonë kadastrale të identifikuar nga drejtoria vendore.

2. Regjistrimi fillestar konsiston në pasqyrimin e çdo pasurie të paluajtshme shtetërore, publike dhe private të zonës kadastrale, në kartelën përkatëse të pasurisë dhe në hartën kadastrale të zonës.

3. Drejtuesi i drejtorisë vendore, një person ose çdo grup i ngarkuar nga Drejtori i Përgjithshëm kërkojnë që pronësia, si dhe kufijtë e çdo pasurie që duhet regjistruar, të dokumentohen në bazë të akteve të fitimit të pronësisë, sipas nenit 193 të Kodit Civil.

4. Individët, familjet dhe personat juridikë privatë apo shtetërorë, që zotërojnë dokumente pronësie, por nuk kanë të përcaktuar në to sipërfaqen, duhet t'i paraqesin regjistruesit një kërkesë për regjistrim pronësie, e cila duhet të shoqërohet me:

a) dokumentin e pronësisë;

b) dokumentacionin hartografik për pasurinë, i cili miratohet nga ASHK-ja;

c) deklaratën noteriale të pronarëve kufitarë, që vërtetojnë përmbajtjen e kërkesës për kufijtë e pasurisë që pretendohet të regjistrohet.

Nëse deklarata noteriale nuk mund të sigurohet, apo ka mosmarrëveshje për kufirin e pasurive, ai përcaktohet nga ASHK-ja. Palët e interesuara kanë të drejtën e ankimit gjyqësor ndaj aktit të ASHK-së që përcakton kufirin.

Drejtoria vendore, brenda 30 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës, duhet t'i kthejë përgjigje kërkuesit. Kundër vendimit të drejtorisë vendore ose në mungesë të përgjigjes brenda afatit, kërkuesi mund të ankohet në gjykatë. Në procesin gjyqësor gjykata thërret të gjithë pronarët, pronat e të cilëve janë kufitare me njëra-tjetrën e të cilët kanë

interes të ligjshëm për gjykim.

5. Kur sipërfaqja që posedohet dhe ekziston efektivisht në terren, është më e vogël se ajo e përcaktuar në titullin e pronësisë, drejtoria vendore regjistron pronësinë vetëm për sipërfaqen që rezulton efektivisht. Nëse nga pozicioni i pasurisë rezulton se sipërfaqja që do t'i takonte titullarit është zënë nga prona publike të ndërtuara pas krijimit të titullit të pronësisë private dhe subjekti nuk është shpërblyer sipas legjislacionit për shpronësimin për interes publik, ASHK-ja njofton organin shtetëror përgjegjës për procedurën e shpronësimit, që të kryejë procedurat përkatëse të kompensimit. Në çdo rast, procedura e regjistrimit nuk pezullohet.

6. Për pasqyrimin e saktë hartografik të pasurive, ASHK-ja shfrytëzon produktin e fotografimit ajror të Republikës së Shqipërisë.

7. Për çdo pasuri të identifikuar nga verifikimi në terren dhe që gjendet në hartën e re kadastrale, krijohet praktika e pronësisë me dokumentacionin që parashikohet në këtë ligj.

8. Procedura e regjistrimit fillestar fillon me vendim të drejtuesit të zyrës vendore ose me vendim të Drejtorit të Përgjithshëm.

9. Mbledhja dhe organizimi i të dhënave, në funksion të procedurave të regjistrimit fillestar dhe të përmirësimit, kryhet nga:

a) vetë ASHK-ja nëpërmjet strukturave dhe personelit të saj; ose

b) subjekte të treta, të kontraktuara nga ASHK-ja, në përputhje me rregullat e legjislacionit "Për prokurimin publik"; ose

c) njësitë e vetëqeverisjes vendore mbi bazën e marrëveshjeve të miratuara nga këshilli drejtues i ASHK-së, sipas nenit 8, pika 4, shkronja "e", të këtij ligji.

Neni 31
Konsultimi publik

1. Pas hartimit të hartës paraprake kadastrale, si dhe përgatitjes së kartelave të pasurive të paluajtshme, në bazë të dokumentacionit të pronësisë të administruar nga drejtoria vendore shpallet publikisht zona që është objekt regjistrimi.

2. Njoftimi publik bëhet në vende të dukshme për të interesuarit e asaj zone kadastrale.

3. Njoftimi duhet të përmbajë kopjen e hartës dhe emrat e pronarëve të pronave që janë identifikuar deri në atë çast nga drejtoria vendore. Njoftimi duhet të caktojë mënyrën dhe vendin ku do të paraqiten pretendimet e të interesuarve.

4. Njoftimi mbetet i afishuar për 45 ditë. Brenda kësaj periudhe lejohet të paraqiten ankesa dhe pretendime nga të interesuarit.

5. Pas kalimit të afatit 45-ditor, drejtoria vendore nuk pranon më ankesa.

Neni 32
Përfundimi i regjistrimit fillestar

1. Pas përfundimit të periudhës së konsultimit publik dhe të trajtimit të ankesave, drejtoria vendore ligjëson regjistrimin e bërë:

a) duke formalizuar kartelën e pasurisë të çdo prone dhe duke arkivuar dokumentacionin përkatës, sipas nenit 13 të këtij ligji;

b) duke formalizuar hartën kadastrale zyrtare, sipas nenit 15 të këtij ligji;

c) duke lëshuar certifikatën e pronësisë për çdo pronar të interesuar të zonës së regjistruar, që ka shlyer tarifat përkatëse të regjistrimit.

2. Drejtoria vendore mund të bëjë vetëm korrigjim të gabimeve në procesin e regjistrimit, por jo të trajtojë ankesa për shtesa të reja. Ankesat paraqiten pranë strukturës së posaçme për ankimet.

Neni 33
Trajtimi i ankesave

1. Struktura e posaçme për ankimet shqyrton çdo kërkesë apo pretendim që nuk është shqyrtuar gjatë procesit të regjistrimit fillestar.

2. Në varësi të gjetjeve, drejtuesi i saj vendos:

a) pranimin e kërkesës dhe detyrimin e drejtorisë vendore për regjistrim të pretendimit;

b) rrëzimin e kërkesës;

c) detyrimin e drejtorisë vendore për shqyrtimin e kërkesës, në harmoni me kufijtë dhe pretendimet e pronarëve kufitarë.

Neni 34
Regjistrimi fillestar i pasurisë shtetërore

Gjatë regjistrimit fillestar të zonës

kadastrale, për pasuritë shtetërore apo të transferuara te njësitë e vetëqeverisjes vendore zbatohen procedurat e parashikuara në legjislacionin për çështjet e pronësisë.

KREU VI
PËRMIRËSIMI I REGJISTRIT

Neni 35
Përmirësimi i regjistrimit

1. Kur evidentohen pasaktësi të hartës kadastrale në tërësi apo gabime materiale që prekin një numër të madh pasurish, ASHK-ja, kryesisht ose me kërkesë të palëve të interesuara, merr nismën për përmirësimin e regjistrit të zonës kadastrale.

2. Përmirësimi është procesi i saktësimit të kufijve, të sipërfaqeve të pasurive të paluajtshme, pasqyrimit të drejtë në hartën kadastrale të pozicionit gjeografik, si dhe saktësimit të të dhënave të regjistrit të pasurive.

Neni 36
Parimet e procesit të përmirësimit

Parimet që udhëheqin përmirësimin, sipas shkallës së rëndësisë së tyre, janë:

a) konsolidimi sistemik i marrëdhënieve të pronësisë mbi pasuritë e paluajtshme;

b) rregullimi i konfiguracionit dhe pozicionit hartografik të titujve të pronësisë, në përputhje me gjendjen faktike;

c) respektimi i sasisë së sipërfaqes të përcaktuar në titujt e pronësisë private, me përjashtim të rasteve të parashikuara në nenet 38, shkronja "b", dhe 39 të këtij ligji;

ç) reflektimi në regjistrin publik i të gjitha veprimeve të kryera me pasurinë, si dhe dokumentimi tekniko-ligjor i tyre;

d) pasqyrimi i detyrueshëm në regjistrin e pasurive i çdo titulli pronësie të depozituar në ASHK. Ky parim nuk zbatohet kur dy ose më shumë tituj pronësie private janë krijuar për të njëjtën pasuri apo pjesë pasurie.

Neni 37
Nivelet e përmirësimit të regjistrit

Përmirësimi zbatohet në dy nivele, që janë:

a) saktësimi dhe korrigjimi i hartës kadastrale, në raport me titujt e pronësisë dhe gjendjen faktike të pasurive;

b) përputhja e të dhënave të titullit të pronësisë me gjendjen faktike të pasurisë. Për këtë qëllim, drejtoria vendore korrigjon gabimet materiale dhe pasaktësitë e tjera në dokumentacionin kadastral, për titujt e krijuar nga organet shtetërore, përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 38
Rregullat e përmirësimit për pasuritë e llojit "tokë"

Për pasuritë e llojit "tokë", mospërputhjet e sipërfaqeve trajtohen si më poshtë:

a) kur sipërfaqja e pasqyruar në hartën kadastrale është më e madhe se sipërfaqja e përcaktuar në titullin e pronësisë, drejtoria vendore i kërkon titullarit të pronësisë të përcaktojë konfigurimin e pasurisë që do të përmirësohet, duke respektuar sasinë e përcaktuar në dokumentin e titullit. Nëse subjekti nuk e realizon brenda 30 ditëve nga njoftimi, konfigurimi kryhet nga drejtoria vendore;

b) kur sipërfaqja që posedohet dhe ekziston efektivisht në terren është më e vogël se ajo e përcaktuar në titullin e pronësisë, zbatohen të njëjtat rregulla si në nenin 30, pika 5, të këtij ligji;

c) problemet e keqpozicionimit të titullit dhe kufijve të tij zgjidhen duke u mbështetur në gjendjen e pasurisë së poseduar faktikisht në terren, për aq sa ajo nuk bie ndesh me tituj të tjerë pronësie privatë. Harta kadastrale apo vetë titujt e pronësisë korrigjohen në përputhje me këtë gjendje.

Neni 39
Rregullat e përmirësimit për ndërtesat

1. Për pasuritë e llojit ndërtesë, problemet e mospërputhjes së pozicionit, konfigurimit, përmasave dhe sasisë së sipërfaqes zgjidhen duke korrigjuar hartën kadastrale dhe regjistrin apo vetë titullin e pronësisë, sipas gjendjes faktike të ndërtesës.

2. Përjashtimisht, kur sipërfaqja në terren është më e madhe se ajo e përcaktuar në titull, drejtoria vendore verifikon nëse në ndërtesë janë kryer zhvillime ndërtimore pa leje dhe i trajton

ato sipas legjislacionit përkatës.

Neni 40
Procedura e përmirësimit të regjistrit

Rregullat procedurale të parashikuara në kreun V, të këtij ligji, zbatohen edhe për procedurën e përmirësimit të regjistrit.

Neni 41
Mënyra dhe mjetet e përmirësimit të regjistrit

Rregullat e hollësishme për mënyrat dhe mjetet teknike-hartografike për realizimin e përmirësimit të regjistrit parashikohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

KREU VII
REGJISTRIMI I TITUJVE DHE AKTEVE TË TJERA

Neni 42
Regjistrimi i kontratës së shitjes

1. Kontrata e shitjes për një pasuri të paluajtshme regjistrohet në seksionin përkatës të kartelës kadastrale, pas verifikimit të elementeve të formës e të përmbajtjes së aktit noterial, të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.

2. Shitja e pasurisë së paluajtshme private bëhet vetëm me akt noterial, të hartuar sipas kërkesave të Kodit Civil dhe të legjislacionit për noterinë.

3. Drejtoria vendore i krijon të gjitha lehtësitë noterit gjatë fazës së hartimit të kontratës së shitjes. Noteri mund të aplikojë për marrjen e informacionit kadastral mbi pronën, objekt shitjeje.

4. Agjencia bën publike të gjitha kërkesat që duhet të plotësojë pronari ose personi i interesuar për të regjistruar kontratën e shitjes.

5. Kontrata paraprake e shitjes regjistrohet në përputhje me dispozitat e Kodit Civil.

Neni 43
Regjistrimi i kontratës së dhurimit

1. Kontrata e dhurimit të pasurisë regjistrohet sipas të njëjtave rregulla që parashikohen në këtë ligj për regjistrimin e kontratës së shitjes.

2. Kontrata e dhurimit regjistrohet vetëm kur:

a) bëhet me akt noterial;

b) përmban të gjitha elementet e parashikuara në këtë ligj, si dhe kërkesat e legjislacionit për noterinë;

c) ekziston i shprehur qartë jo vetëm vullneti i dhuruesit për kalimin e pronës së identifikuar, por edhe vullneti i pranuesit për ta pranuar atë (me përjashtim të rasteve kur përfitues është shteti).

3. Drejtoria vendore regjistron kontratën sipas përmbajtjes, përfshirë edhe barrët ligjore që ajo mund të mbartë në të ardhmen.

4. Drejtoria vendore regjistron kontratën e dhurimit sipas çmimit të referencës të momentit të regjistrimit, të përcaktuar në legjislacionin në fuqi.

Neni 44
Regjistrimi i pasurisë në bashkëpronësi dhe pas pjesëtimit

1. Kur prona është në emër të disa bashkëpronarëve dhe në aktin e krijimit të bashkëpronësisë nuk përcaktohen raportet e pjesëve takuese, këto pjesë prezumohen të barabarta.

2. Përjashtimisht, për pasuritë që i nënshtrohen regjimit të bashkëpronësisë në tërësi, sipas Kodit Civil, nuk vlen parimi i prezumimit të barazisë së pjesëve. Për këto pasuri, në përputhje me Kodin Civil, raportet e pjesëve përcaktohen vetëm në momentin e ndarjes (pjesëtimit) të pasurisë, me marrëveshje noteriale të bashkëpronarëve apo me vendim gjyqësor.

3. Në çdo rast, akti noterial ose vendimi i gjykatës që pjesëton pasurinë takuese përmban:

a) emrat dhe identitetet e bashkëpronarëve, siç janë të renditura në kartelën kadastrale;

b) të dhënat e pasurisë, sipas hartës kadastrale;

c) pjesët takuese në përqindje, në metra katrorë, si dhe pozicionin fizik në hartë për secilin bashkëpronar;

ç) hartën e re që përftohet pas dakordësimit nga ndarja;

d) elemente të tjera që kërkon ligji për noterinë.

4. Drejtoria vendore, pas marrjes së kërkesës për regjistrim, regjistron ndarjen e bashkëpronësisë dhe bën reflektimet në kartelë dhe në hartën kadastrale.

Neni 45
Regjistrimi i pasurisë së bashkësisë ligjore dhe rastet e tjera të përfitimit të pronësisë me ligj

1. Nëse pasuria, objekt i kontratës së kalimit të pronësisë, realizuar në favor të personave fizikë, të cilët në regjistrin e gjendjes civile kanë statusin e të martuarit, është pasuri e fituar gjatë martesës, në përputhje me nenin 76, të Kodit të Familjes, regjistrimi në seksionin përkatës të kartelës së pasurisë bëhet në bashkëpronësi të të dy bashkëshortëve, për sa kohë ata nuk provojnë se i nënshtrohen një regjimi pasuror martesor të veçantë.

2. Drejtoria vendore korrigjon ose përditëson të dhënat kadastrale për pasuritë e paluajtshme në bashkëpronësi të të dy bashkëshortëve, të fituara gjatë martesës përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, në rast se kjo kërkohet me shkrim nga bashkëshorti që nuk është i regjistruar dhe vërtetohet nga certifikata e gjendjes familjare në kohën kur është fituar pasuria.

3. Paragrafi i parë dhe i dytë i këtij neni, zbatohen edhe për regjistrimin e pasurive të legalizuara, si dhe për regjistrimin e kontratës së sipërmarrjes, porosisë e të premtimit për shitje, kur këto të fundit synojnë kalimin e pronësisë së objektit në ndërtim, në të ardhmen.

4. Kur ligji i posaçëm parashikon fitimin ose shuarjen e të drejtave pasurore automatikisht me verifikimin e fakteve juridike, ose kushteve, që nuk varen nga vullneti i shprehur i subjektit përfitues, drejtoria vendore është e detyruar të kryejë shënimet përkatëse në kartelën e pasurisë, pas administrimit të dokumentacionit që provon realizimin e faktit apo kushtit të caktuar.

Neni 46
Regjistrimi i pasurisë së fituar me parashkrim fitues

1. Regjistrimi i fitimit të pronësisë mbi një pasuri të paluajtshme, me parashkrim fitues, bëhet pas paraqitjes në zyrën vendore të kadastrës të vendimit gjyqësor të formës së prerë.

2. Vendimi gjyqësor, që vërteton faktin juridik të pronësisë, i miratuar pas datës 1.11.1994, nuk regjistrohet.

3. Vendimi gjyqësor duhet të përmbajë të dhënat zyrtare nga kartela dhe harta kadastrale e zonës përkatëse, për sa u përket elementeve identifikuese të pasurisë dhe pronarëve.

4. Regjistrimi i fitimit të pronësisë, sipas këtij neni, bëhet nga drejtoria vendore pas plotësimit të kushteve të regjistrimit, të përcaktuara në nenet 170 dhe 193 të Kodit Civil.

5. Në rast se nuk plotësohen kushtet e sipërpërmendura, Drejtoria e Përgjithshme, me vendim të arsyetuar, vendos refuzimin e kërkesës për regjistrim.

6. Kundër vendimit për refuzimin e regjistrimit mund të bëhet ankim në rrugë gjyqësore.

Neni 47
Regjistrimi i kalimit të pronësisë me vendim gjykate ose akt administrativ

1. Regjistrimi i fitimit të pronësisë mbi një pasuri të paluajtshme në bazë të vendimit gjyqësor të formës së prerë për fitimin apo kalimin e së drejtës së pronësisë apo të aktit të një organi administrativ, bëhet nga drejtoria vendore, pas paraqitjes së këtyre akteve, sipas procedurës së parashikuar në nenet 24 dhe 25, të këtij ligji, dhe plotësimit të kushteve të regjistrimit, të parashikuara në nenin 193 të Kodit Civil.

2. Nëse nuk plotësohen kushtet e sipërpërmendura, Drejtoria e Përgjithshme vendos refuzimin e kërkesës për regjistrim.

3. Kundër vendimit për refuzimin e regjistrimit mund të bëhet ankim në rrugë gjyqësore.

Neni 48
Regjistrimi i lejes së ndërtimit

1. Brenda 20 ditëve nga dita e lëshimit të lejes së ndërtimit, bashkia që e ka lëshuar atë, e depoziton në zyrën vendore kadastrale. Depozitimi bëhet me shkresë zyrtare, e cila shërben si kërkesë.

2. Leja e ndërtimit përfshin:

a) modelin zyrtar dhe origjinal të lejes së nënshkruar nga kryetari i bashkisë;

b) projektin inxhinierik, shoqëruar me

planvendosjen e objektit, planimetritë e secilit kat me njësitë individuale përkatëse (apartamente apo njësi shërbimi) dhe elemente të tjera që tregojnë lartësinë e objektit dhe vendin që zë infrastruktura;

c) emrin dhe të dhënat e sakta të investitorit;

ç) të dhëna të tjera.

3. Leja së bashku me praktikën shoqëruese regjistrohet në një regjistër të posaçëm që mbahet dhe administrohet nga zyra vendore e kadastrës. Modeli dhe rregullat e mbajtjes së këtij regjistri përcaktohen me udhëzim të Këshillit të Ministrave.

4. Gjatë procesit të regjistrimit të lejes, zyra kadastrale sigurohet të krahasojë të dhënat e hartave të lejes me hartat kadastrale zyrtare. Gjatë këtij verifikimi zyra kadastrale verifikon edhe aktet noteriale që kanë vendosur barrë mbi tokën.

5. Në përputhje me nenin 534, të Kodit Civil, hipotekat dhe barrët e tjera që rëndojnë mbi tokën mbarten në ndërtimin e ardhshëm apo mbi pjesët e tij që i janë premtuar pronarit të tokës, sipas marrëveshjes me subjektin investitor.

6. Kur ndërtimi është vepër publike dhe pa pronarë privatë, drejtoria vendore kryen regjistrimin e lejes së ndërtimit, duke vendosur edhe barrë ligjore mbi tokën publike.

7. Të njëjtat rregulla zbatohen edhe për lejet që miratohen nga Këshilli Kombëtar i Territorit.

Neni 49
Regjistrimi i karabinasë

1. Për çdo ndërtim, leja e të cilit është regjistruar paraprakisht në drejtorinë vendore, përditësohet në çdo fazë të ndërtimit të tij deri në përfundimin e plotë të karabinasë.

2. Drejtoria vendore regjistron çdo fazë të ndërtimit të karabinasë, deri në përfundimin e ndërtimit. Fazat ndërtimore konfirmohen zyrtarisht nga bashkia ose autoriteti publik që ndjek zbatimin e punimeve. Konfirmimi i punimeve të kryera lëshohet me shkrim.

3. Regjistrimi i karabinasë bëhet në një regjistër të veçantë, që quhet "Regjistri i karabinasë". Çdo regjistrim fillon duke u referuar në ekstremitetet e lejes së ndërtimit, të lëshuar për këtë qëllim.

Neni 50
Regjistrimi i kontratave të sipërmarrjes/porosisë apo premtim shitje

1. Çdo kontratë sipërmarrjeje, porosie apo premtimi shitjeje e investitorit me pronarin e truallit apo me të tretë, që synon në të ardhmen kalimin e pronësisë së objektit në ndërtim, regjistrohet në regjistrin e lejes së ndërtimit dhe më tej në regjistrin e karabinasë. Ky regjistrim e bën njësinë përkatëse të objektit "të zënë" dhe që nuk mund t'i premtohet dikujt tjetër.

2. Në të gjitha kontratat e sipërpërmendura duhet të individualizohet njësia ndërtimore (apartament ose njësi shërbimi) sipas planimetrive që i bashkëlidhen lejes së ndërtimit. Në të kundërt regjistrimi i tyre refuzohet.

3. Pronarët e truallit nuk mund të cedojnë të drejtat mbi pjesët e tyre të ardhshme në ndërtim (të premtuara nga investitori) tek të tretët, nëse mbi truallin rëndon një e drejtë hipotekore, sipas parashikimeve të nenit 48, pika 5, të këtij ligji. Veprimet juridike-civile që bien ndesh me këtë pikë dhe me parashikimet e Kodit Civil nuk regjistrohen.

4. Investitori, që është njëkohësisht edhe pronar i truallit të vendosur më parë në hipotekë, nuk mund t'u premtojë të tretëve njësi ndërtimore, pa miratimin me shkrim të kreditorit hipotekor. Anasjelltas, nëse mbi truallin nuk rëndonte më parë hipotekë, investitori mund të vendosë në hipotekë, për garantimin e debisë së tij, vetëm ato njësi ndërtimore, për të cilat nuk ka lidhur më parë kontrata porosie /sipërmarrjeje/premtimi shitjeje me të tretët. Veprimet juridike-civile që bien ndesh me këtë pikë dhe me parashikimet e Kodit Civil nuk regjistrohen.

5. Në çdo rast, ekzekutimi i detyrueshëm mbi karabinatë për shlyerjen e debive të investitorit shtrihet vetëm mbi pasuritë që nuk i janë premtuar të tretëve, sipas kontratave përkatëse të porosisë. Përjashtim bën rasti kur debia është garantuar nga një e drejtë hipoteke mbi pasurinë, që është më e hershme se kontratat e porosisë të lidhura me të tretët.

6. Pas regjistrimit të kontratave, drejtoria vendore lëshon vërtetime regjistrimi në favor të palëve kontraktore. Vërtetimi i regjistrimit provon regjistrimin e njësisë/objektit sipas

parashikimeve kontraktore.

7. Ngarkohet Këshilli i Ministrave të përcaktojë rregulla më të detajuara për zbatimin e kësaj procedure.

Neni 51

Regjistrimi përfundimtar i ndërtimeve të reja

1. Pas përfundimit të ndërtimeve, certifikata e përdorimit të objektit, që lëshohet sipas ligjit nga bashkia ose autoriteti që ka lëshuar lejen e ndërtimit, i dërgohet zyrtarisht drejtorisë kadastrale, sipas së njëjtës procedurë me të cilën u depozitua leja e ndërtimit.

2. Drejtoria vendore, me marrjen e certifikatës së përdorimit, regjistron në regjistrin e pronësisë ndërtimin e përfunduar dhe më pas çel kartelat kadastrale për çdo pronar, me të cilët ndërtuesi ka lidhur kontratën e shitjes, sipas kërkesave të këtij ligji.

3. Kontrata e shitjes duhet të ketë të njëjtat referenca si kontratat paraprake. Në rast ndryshimesh, drejtoria vendore e kadastrës ndërpret regjistrimin dhe kërkon të dhëna shtesë. Kur edhe pas kësaj kërkese kontrata e shitjes ndryshon nga aktet e ndërmjetme, drejtoria kërkon deklaratë noteriale të lëshuar nga personat që nuk janë më përfitues. Çdo kontratë shitjeje, që ka blerës persona të ndryshëm nga ato që ishin përfitues në aktet e ndërmjetme të porosisë apo sipërmarrjes, duhet të përfshijë edhe personin e larguar si palë e interesuar në kontratën e re të shitjes.

4. Në kartelën e pasurisë të çdo njësie individuale bëhet dhe shënimi për kuotën e pjesëmarrjes në bashkëpronësinë e detyrueshme.

Neni 52

Regjistrimi i mjediseve të përbashkëta në ndërtesa

1. Në kartelën kadastrale ku është regjistruar objekti i ri në tërësi përcaktohen sipërfaqet që zënë njësitë individuale dhe sipërfaqet e përbashkëta.

2. Sipërfaqet e përbashkëta regjistrohen në tërësi dhe me kuota të ndara për çdo pronar të njësisë individuale. Ndalohet regjistrimi me pjesë takuese në favor të pronarëve i sipërfaqes së përbashkët.

3. Nëse nuk parashikohet ndryshe në titullin e pronësisë, konsiderohen sipërfaqe të përbashkëta:

a) shkallët dhe sheshpushimet ndërmjet tyre;

b) trualli ku qëndron godina;

c) tarraca/çatitë, muret mbajtëse, kolonat, themelet, kalimet;

ç) puset teknike dhe vendet ku vendoset infrastruktura e ndërtimit, bodrumet, puset, parkimet, ashensorët, depozitat e ujit, kaldaja, si dhe infrastruktura e përbashkët;

d) sheshet e përbashkëta;

dh) çdo element tjetër që përmban projekti ndërtimor që i bashkëlidhet lejes së ndërtimit.

Neni 53

Regjistrimi i titujve të tjerë që buron nga legjislacioni për çështjet e pronësisë

1. Regjistrimi i pasurive të legalizuara bëhet në përputhje me përmbajtjen e dokumentacionit të legalizimit.

2. Ndërtimet e legalizuara mbi truall në pronësi të të tretëve regjistrohen pa marrëdhënie me truallin, deri në miratimin e vendimit të Këshillit të Ministrave për kompensimin e pronarëve joposedues, sipas procedurës së parashikuar në legjislacionin për çështjet e pronësisë. Me miratimin e këtij vendimi, parcela ndërtimore regjistrohet në favor të përfituesit të pasurisë së legalizuar.

3. Në çdo rast, deri kur përfituesi i ndërtimit të legalizuar të ketë shlyer detyrimin financiar për parcelën ndërtimore, mbi pasurinë e legalizuar regjistrohet hipoteka ligjore.

4. Regjistrimi i titujve që burojnë nga aktet e organeve të qeverisjes vendore, të nxjerra përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, kryhet në përputhje me rregullat e përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 54

Regjistrimi i heqjes dorë nga e drejta e pronësisë

Veprimi juridik i heqjes dorë nga e drejta e pronësisë regjistrohet në regjistrin publik të pasurive të paluajtshme, në përputhje me dispozitat e Kodit Civil.

Neni 55
Regjistrimi i servituteve dhe shuarja e tyre

1. Pronari i një pasurie të paluajtshme regjistron një servitut, duke i paraqitur drejtorisë vendore aktin e krijimit të servitutit, në formën e kërkuar nga ligji, i cili duhet të përmbajë:

a) natyrën e servitutit, periudhën për të cilën ka efekt ky servitut, si dhe ndonjë kusht apo kufizim që ka efekt mbi të;

b) pasurinë e paluajtshme ose pjesën e saj, që preket nga ky servitut.

2. Dokumenti, me anë të të cilit zbatohet një servitut, administrohet nga drejtoria vendore. Ai përmban një plan rilevimi, që nevojitet për të përcaktuar vendndodhjen dhe shtrirjen e servitutit. Servituti regjistrohet në seksionin përkatës të kartelës kadastrale.

3. Me kërkesë të personit, në dobi të të cilit është regjistruar servituti, bëhet ndryshimi ose shuarja e regjistrimit të mëparshëm.

Neni 56
Regjistrimi i hipotekës dhe fshirja

1. Në çdo kartelë pronësie, si dhe në regjistrin e titujve të pronësisë, drejtoria vendore regjistron hipotekën, si barrë për çdo pronar kur:

a) kërkohet prej personit të interesuar me një akt noterial, që përcakton qartë pronën ose pjesën e saj që do të lihet në hipotekë;

b) vendoset nga një akt administrativ, të autorizuar nga ligji;

c) vendoset nga gjykata;

ç) është parashikuar me ligj.

2. Hipoteka mund të vendoset për të gjithë ose për një pjesë të pasurisë, sipas përcaktimeve të aktit ku është vendosur.

3. Hipoteka shuhet dhe fshihet nga regjistri sipas rasteve të parashikuara në Kodin Civil.

4. Gjatë kohëzgjatjes së hipotekës nuk regjistrohet asnjë kontratë për kalimin e pronësisë tek të tretët.

Neni 57
Regjistrimi i kontratës së qirasë dhe enfiteozës

1. Çdo kontratë qiraje, e bërë me akt noterial për një pasuri të paluajtshme, me zgjatje kohore më shumë se 9 vjet, duhet të regjistrohet në seksionin përkatës të kartelës së pasurisë. Kontrata e qirasë, e bërë me akt noterial për një pasuri të paluajtshme, me një zgjatje kohore mbi një vit, mund të regjistrohet në regjistrin e pasurisë së paluajtshme.

2. Kur një kontratë qiraje është për një pjesë të një pasurie të paluajtshme, atëherë kartela ekzistuese e pasurisë së paluajtshme mbyllet dhe hapen kartela të reja për pjesën/pjesët që është/janë dhënë me qira dhe për pjesën/pjesët e pasurisë së paluajtshme që mbetet/mbeten, si dhe bëhen shënimet përkatëse në hartën kadastrale, sipas përcaktimeve të bëra në nenin 15 të këtij ligji.

3. Kontrata e enfiteozës regjistrohet në regjistrin publik të pasurive të paluajtshme, sipas përcaktimeve të dispozitave të Kodit Civil.

Neni 58
Regjistrimi i së drejtës së parablerjes

1. Drejtoria vendore regjistron kërkesën e çdo të interesuari direkt, sipas Kodit Civil apo ligjit të posaçëm, për të garantuar të drejtën e parablerjes së një pasurie të paluajtshme.

2. Kërkuesi duhet të provojë interesin legjitim në lidhje me pronën, duke treguar se është në kushtet e përfitimit nga e drejta e parablerjes. Kërkesa ka në përmbajtje faktin, nëpërmjet të cilit njihet e drejta e parablerjes dhe shoqërohet me dokumentacionin që provon interesin legjitim.

3. Në këtë rast, drejtoria vendore, pasi bën regjistrimin e së drejtës së parablerjes, lëshon vërtetim për regjistrimin.

Neni 59
Regjistrimi i titujve në përdorim

1. Kushdo që ka në përdorim një pasuri shtetërore apo publike, dhënë sipas ligjeve në fuqi, regjistron këtë pasuri në drejtorinë vendore si pronë të marrë në përdorim.

2. Drejtoria vendore e regjistron pronën e dhënë në përdorim, duke bërë shënimin në kartelën e pasurisë. Regjistrimi bëhet me kërkesë, e cila shoqërohet me aktin e marrjes në përdorim nga institucioni shtetëror që administron pronën.

Neni 60
Regjistrimi i prokurës

1. Prokura regjistrohet në kartelën e pasurisë së pronarit që e ka lëshuar atë, kur e kërkon ai vetë ose përfaqësuesi.

2. Prokura regjistrohet vetëm kur është akt noterial, për pasuritë e personave privatë, ndërsa për personat juridikë publikë regjistrohet dhe autorizimi i lëshuar nga titullari.

3. Në çdo rast prokura duhet të përmbajë referenca të sakta mbi veprimet që lejohet të kryhen me pronën nga ana e përfaqësuesit, referenca të sakta mbi pronën dhe mbi të dhënat e tjera që përmban kartela e pasurisë apo certifikata.

Neni 61
Regjistrimi i akteve të kryera në shtete të tjera

Aktet e krijuara jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, të cilat pronari ose personi i interesuar kërkon t'i regjistrojë në kadastër, duhet të jenë të përkthyera dhe të vërtetuara sipas kërkesave të marrëveshjeve ndërkombëtare dhe legjislacionit të posaçëm.

Neni 62
Regjistrimi i pemëve dhe i pasurive natyrore

1. Çdo pemë, në tokë shtetërore apo private, duhet regjistruar në zyrën kadastrale të vendit ku ndodhen. Pronari i tyre duhet të paraqitet me një hartë dhe me një inventar të detajuar të pemëve që gjenden në pronën e tij. Për pemët në parqe publike dhe pyje rolin e pronarit e kryen autoriteti shtetëror, sipas legjislacionit përkatës.

2. Pas paraqitjes së hartës, inventarit të pemëve dhe një kërkese, drejtoria vendore, përkundrejt pagesës, pajis pronarin me sasinë e nevojshme të matrikujve, të cilat është i detyruar t'i vendosë në çdo pemë.

3. Këshilli i Ministrave përcakton rregulla të detajuara për këtë proces, si dhe për pasqyrimin në hartat kadastrale të pasurive natyrore, si male, lumenj, liqene, basene, miniera, puse nafte e çdo pasuri tjetër natyrore.

KREU VIII
TARIFAT, KUNDËRVAJTJET DHE ANKIMI

Neni 63
Tarifat e shërbimit kadastral

1. Çdo shërbim kadastral që ofrohet, me përjashtim të rasteve të veçanta, të parashikuara në këtë ligj, tarifohet.

2. Lista e shërbimeve kadastrale dhe tarifat për çdo shërbim përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

3. Për çdo shërbim të përjashtuar nga tarifa, Këshilli i Ministrave vendos për kompensimin e tarifës nga fondet e buxhetit të shtetit.

Neni 64
Kundërvajtjet

1. Konsiderohen kundërvajtje administrative shkeljet e mëposhtme:

a) të gjitha shkeljet e dispozitave të këtij ligji, që nuk përbëjnë vepër penale;

b) vonesat në përgjigje të kërkesave;

c) kalimi i afateve të regjistrimit;

ç) humbja e dokumentacionit;

d) ndërhyrja e paautorizuar në regjistrat e kadastrës, përfshirë edhe ato elektronikë, kur nuk ka pasojë.

2. Për këto shkelje drejtuesi i Agjencisë dhe struktura përgjegjëse për ankimin vendos për dënimin me gjobë nga 5 000 deri në 500 000 lekë. Masa e gjobës caktohet në varësi të shkeljes së kryer dhe pasojës që ka sjellë për përfituesin e shërbimit.

3. Kundër vendimit të dënimit me gjobë, punonjësi ka të drejtë të ankohet në gjykatën administrative brenda 5 ditëve.

Neni 65
Ankimet kundër Agjencisë

1. Administrativisht, kundër akteve kadastrale ose mosveprimeve të Agjencisë paraqitet ankim te struktura përgjegjëse për ankimet, sipas përcaktimeve të Kodit të Procedurave Administrative.

2. Pas shqyrtimit të ankimit, sipas dispozitave të Kodit të Procedurave Administrative, kërkuesit i lind e drejta e ankimit gjyqësor brenda 45 ditëve nga njoftimi i vendimmarrjes mbi ankimin apo nga data e mbarimit të afatit ligjor të shqyrtimit të ankimit, në rastin mosveprimit të ASHK-së.

Neni 66
Pjesëmarrja e detyrueshme e ASHK-së në proceset gjyqësore

1. Gjatë shqyrtimit gjyqësor të mosmarrëveshjeve civile që kanë të bëjnë me kufijtë , apo sipërfaqet e pasurive të paluajtshme, kërkohet në çdo rast pjesëmarrja e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, si person i tretë, sipas rregullave të parashikuara në Kodin e Procedurës Civile.

2. Gjatë shqyrtimit të mosmarrëveshjeve civile, sipas pikës 1 të këtij neni, kur për nevoja të gjykimit, është i domosdoshëm dokumentacioni kadastral, Gjykata mund të urdhërojë drejtorinë vendore përkatëse t'i hartojë ato sipas parashikimeve të këtij ligji.

KREU IX
DISPOZITA TË FUNDIT DHE KALIMTARE

Neni 67
Ngritja e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës

1. Agjencia Shtetërore e Kadastrës krijohet si bashkim i AITPP-së, ALUIZNI-t dhe ZRPP-së.

2. Agjencia Shtetërore e Kadastrës krijohet jo më vonë se 1 muaj nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

3. Pas krijimit të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, të gjitha detyrat dhe përgjegjësitë e Agjencisë së Legalizimit Urbanizimit dhe Integrimit të Zonave/Ndërtimeve Informale dhe Agjencisë së Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave Publike i ngarkohen ASHK-së.

Neni 68
Bashkëpunimi ndërinstitucional

1. ASHK-ja, bashkërendon veprimtarinë me Avokaturën e Shtetit, Autoritetin Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG), Arkivin e Shtetit, Arkivin Qendror Teknik të Ndërtimit, organet e vetëqeverisjes vendore dhe çdo institucion apo strukturë tjetër, veprimtaria e të cilit lidhet me çështjet e pronësisë.

2. Çdo institucion shtetëror apo ent tjetër, veprimtaria e të cilit lidhet apo ka përgjegjësi në realizimin e proceseve, sipas këtij ligji apo ligjeve dhe akteve të tjera nënligjore të miratuara, ka për detyrë të bashkëpunojë dhe t'i ofrojë gjithë informacionin e duhur ASHK-së, pa asnjë tarifë.

Neni 69
Dispozitë kalimtare

1. Arkivi, mjetet e punës, logjistika, baza materiale, sistemet elektronike dhe digjitale të institucioneve që përfshihen në ristrukturim, i transferohen në përgjegjësi administrimi Agjencisë Shtetërore të Kadastrës.

2. Fondet buxhetore, të planifikuara për ALUIZNI-n dhe AITPP-në dhe fondet e ZRPP-së, pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, përdoren nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës.

Për vitin 2019, të ardhurat e krijuara nga proceset e legalizimit të ndërtimeve pa leje dhe rregullimit të pronësisë në zonat e stimuluara derdhen në buxhetin e shtetit. Përjashtohen këtu të ardhurat që transferohen për llogari të fondit financiar të kompensimit të pronave, sipas përcaktimeve të legjislacionit, "Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave", si dhe të ardhurat që do të përdoren nga ASHK-ja.

3. Për emërimin e organeve të para drejtuese dhe fillimin e funksionimit të Agjencisë, sipas afatit të parashikuar në pikën 2, të nenit 67, të këtij ligji, zbatohen procedurat e mëposhtme:

a) institucionet e përcaktuara në nenin 8, pika 1, të këtij ligji, dërgojnë pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave, emrat e përfaqësuesve të tyre në Këshillin Drejtues të ASHK-së, jo më vonë se shtatë ditë nga hyrja në fuqi e këtij ligji;

b) Kryeministri emëron Drejtorin e Përgjithshëm të ASHK-së brenda 10 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji;

c) brenda 15 ditëve nga hyrja në hyrja në fuqi e këtij ligji, thirret mbledhja e parë e Këshillit Drejtues të ASHK-së, në të cilën propozohet për miratim struktura dhe organika e Agjencisë, si dhe niveli i pagave të punonjësve të Agjencisë, në përputhje me parashikimet e nenit 8, pika 4, shkronjat "ë" dhe "f", të këtij ligji.

4. Të gjithë punonjësit e Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Agjencisë së Legalizimit, Urbanizimit dhe Integrimit të Objekteve/Ndërtimeve Informale, konsiderohen punonjës të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës për një periudhë kalimtare 6-mujore nga hyrja në fuqi e këtij ligji, nëse nuk preken nga ristrukturimi dhe

plotësojnë kriteret e kualifikimit, sipas rregulloreve të miratuara nga këshilli drejtues i ASHK-së.

Përjashtimisht për punonjësit e Agjencisë së Inventarizimit të Pronave të Paluajtshme Publike ndiqen procedurat e parashikuara në legjislacionin për nëpunësin civil.

5. Deri në krijimin e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Agjencia e Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave Publike dhe Agjencia e Legalizimit Urbanizimit dhe Integrimit të Zonave/Ndërtimeve Informale, vijojnë të kryejnë shërbimet rregullisht, sipas ligjeve që janë ende në fuqi.

6. Praktikat në proces, të paraqitura për regjistrim pranë Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, trajtohen sipas parashikimeve të këtij ligji.

Neni 70

Përjashtimet dhe shuarja e kamatëvonesave në regjistrim

1. Të gjitha subjektet që gëzojnë një titull pronësie apo të drejtë tjetër reale, të fituar në përputhje me ligjin dhe të regjistrueshëm në regjistrat publikë, sipas nenit 193, të Kodit Civil, dhe që nuk kanë aplikuar për regjistrim pranë zyrave të regjistrimit të pasurive të paluajtshme brenda afatit ligjor, rivendosen në afat për aplikim, 30 ditë, duke filluar nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

2. Të gjitha kamatëvonesat që janë gjeneruar nga sistemi i regjistrimit të pasurive të paluajtshme, deri në hyrjen në fuqi të këtij ligji, për shkak të mosaplikimit në kohë për regjistrim të dokumentacionit, sipas nenit 39, të ligjit nr. 33/2012, "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", të ndryshuar, shuhen. Subjektet, që aplikojnë brenda afatit të parashikuar në pikën 1, të këtij neni, paguajnë vetëm tarifën aktuale për regjistrimin e aktit.

Neni 71

Aktet nënligjore

1. Përveç sa parashikohen shprehimisht në dispozita të tjera të këtij ligji, Këshilli i Ministrave përcakton:

a) procedurat e hollësishme të regjistrimit të titujve të pronësisë që nuk kanë të përcaktuar në të sipërfaqen, sipas pikës 4, të nenit 30;

b) elementet formale të akteve noteriale, vendimeve gjyqësore apo akteve administrative që kontrollohen për efekt regjistrimi, sipas këtij ligji.

2. Këshilli i Ministrave miraton aktet nënligjore brenda 12 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 72

Shfuqizime

1. Ligji nr. 33/2012, datë 21.3.2012, "Për regjistrimin e pasurisë së paluajtshme", i ndryshuar, si dhe çdo dispozitë në ndonjë ligj tjetër që bie ndesh me këtë ligj, shfuqizohen me hyrjen në fuqi të këtij ligji.

2. Aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të ligjit "Për regjistrimin e pasurisë së paluajtshme" qëndrojnë në fuqi dhe zbatohen, për aq sa nuk bien ndesh me parashikimet e këtij ligji, deri në nxjerrjen e akteve të reja nënligjore.

3. Deri në miratimin e modeleve të akteve të reja kadastrale, ASHK-ja vijon të përdorë modelet e akteve të miratuara përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 73

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Gramoz Ruçi

Miratuar më 7.2.2019

DEKRET
Nr.11133, datë 4.3.2019

PËR SHPALLJEN E PROCEDURËS SË APLIKIMIT PËR PLOTËSIMIN E VENDIT VAKANT GJYQTAR NË GJYKATËN KUSHTETUESE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 93, 125, 127 pika 1/b, 3, 179 pika 2 të Kushtetutës, si dhe të neneve

7,7/a, 7/b, 86 pika 4 shkronja "c", të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, si dhe referuar shkresës nr.79 prot., datë 25.2.2019 të Gjykatës Kushtetuese, me të cilën njoftohet se më datë 25.5.2019 në Gjykatën Kushtetuese, krijohet një vakancë e plotë, me cilësinë e organit të emërtesës,

DEKRETOJ:

Neni 1

Shpalljen e procedurës së aplikimit për emërim gjyqtari në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, me qëllim plotësimin e **"Vakancës së plotë",** që krijohet më datë 25.5.2019.

Neni 2

Shpallja e kësaj procedure dhe publikimi i saj sipas tekstit bashkëlidhur, të bëhet menjëherë në mjetet e informimit publik dhe në faqen zyrtare të internetit të Institucionit të Presidentit të Republikës.

Neni 3

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta

NJOFTIM
SHPALLJE PËR HAPJEN E PROCEDURAVE TË APLIKIMIT PËR VENDIN VAKANT GJYQTAR NË GJYKATËN KUSHTETUESE (VAKANCË E PLOTË)

Presidenti i Republikës, në mbështetje të nenit 93, 125, 127 pika 1/"b", 3, 179 pika 2 të Kushtetutës, si dhe të neneve 7,7/ "a", 7/b, 86 pika 4 shkronja "c", të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, si dhe referuar shkresës nr. 79 prot., datë 25.2.2019 të Gjykatës Kushtetuese, me të cilën njoftohet se më datë 25.5.2019 në Gjykatën Kushtetuese do të krijohet një vakancë e plotë, për shkak se kjo datë konsiderohet rregullisht si moment i përfundimit të mandatit 9-vjecar që do të mund të ushtrohej nga ish-gjyqtarja e kësaj gjykate znj. Altina Xhoxhaj apo nga gjyqtari që plotëson vakancën e parakohshme pas shkarkimit të saj, Presidenti i Republikës me cilësinë e organit të emërtesës dhe me qëllim plotësimin e "Vakancës së plotë", të krijuar në Gjykatën Kushtetuese, me Dekretin nr. 11133, datë 4.3.2019, ka miratuar:

- Shpalljen e procedurës së aplikimit për emërim gjyqtari në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, me qëllim plotësimin e "Vakancës së plotë", që krijohet më datë 25.5.2019.

Presidenti i Republikës fton:

Çdo person të interesuar që plotëson kushtet dhe kriteret e parashikuara në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, nenin 7/a të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, të marrë pjesë në këtë procedurë të konkurrimit të hapur publik, për vakancën e mësipërme, për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese dhe të paraqesë pranë Institucionit të Presidentit të Republikës:

- Kërkesën për shprehjen e interesit për të kandiduar për vendin vakant të shpallur;
- Jetëshkrimin, me të dhënat e plota të kontaktit (adresë, numër telefoni/e-mail);
- Fotokopje të kartës së identitetit;
- Dokumentacionin shoqërues nëpërmjet të cilit vërteton përmbushjen e kushteve dhe kritereve të përcaktuara në nenin 7/"a" të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.
- Formularin e vetëdeklarimit të plotësuar dhe nënshkruar sipas përcaktimeve të ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë

funksione publike". Formulari i vetëdeklarimit, është i publikuar në faqen kryesore të Institucionit të Presidentit të Republikës.

- Formularin e aplikimit të plotësuar "Për informim përpara emërimit/zgjedhjes në poste të larta", në përputhje me parashikimet ligjore të nenit 29, të ligjit nr. 45/2015, "Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë", formular ky i cili është i publikuar në faqen kryesore të Institucionit të Presidentit të Republikës.

- Listën e dokumentacionit që dorëzohet bashkëlidhur kërkesës të nënshkruar nga aplikanti.

Për lehtësinë e të gjithë aplikantëve, me qëllim plotësimin e dokumentacionit të nevojshëm, më poshtë gjeni të botuar përmbajtjen e nenit 125, pika 4 e 5 të Kushtetutës dhe nenit 7/"a" të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, ku parashikohen kushtet dhe kriteret për emërimin e gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese,

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë

Neni 125

4. Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese duhet të kenë arsim të lartë juridik, të paktën 15 vjet përvojë pune si gjyqtarë, prokurorë, avokatë, profesorë ose lektorë të së drejtës, nëpunës të nivelit të lartë në administratën publike, me një veprimtari të spikatur në fushën e së drejtës kushtetuese, të drejtave të njeriut ose në sfera të tjera të së drejtës.

5. Gjyqtari nuk duhet të ketë mbajtur funksione politike në administratën publike ose pozicione drejtuese në një parti politike gjatë 10 vjetëve të fundit përpara kandidimit. Kritere të tjera, si dhe procedura për emërimin dhe zgjedhjen e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese rregullohen me ligj.

- Ligji nr. 8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

Neni 7/a
Kriteret dhe kushtet e emërimit të gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese

1. Gjyqtari i Gjykatës Kushtuese mund të zgjidhet shtetasi shqiptar që përmbush këto kushte:

a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;

b) të ketë mbaruar arsimin e lartë juridik, Diplomë e Nivelit të Dytë;

c) të mos ketë ushtruar funksione politike në administratën publike dhe të mos ketë mbajtur pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 viteve të fundit nga data e kandidimit;

ç) të mos jetë në procedim penal dhe të mos jetë dënuar me burgim për kryerjen e një vepre penale;

d) të mos jetë larguar nga detyra për shkaqe disiplinore dhe të mos ketë masë disiplinore në fuqi;

dh) të ketë kaluar me sukses procesin e kontrollit dhe verifikimit të pasurisë së tij personale dhe të familjarëve të tij, sipas ligjit.

2. Kandidati që përmbush kushtet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni, duhet të plotësojë edhe këto kritere:

a) të ketë përvojë pune jo më pak se 15 vjet si gjyqtar, prokuror, avokat, profesor ose lektor i së drejtës, jurist i nivelit të lartë në administratën publike;

b) të ketë një veprimtari të njohur në fushën e të drejtës kushtetuese, të drejtave të njeriut ose sfera të tjera të së drejtës;

c) të jetë vlerësuar për aftësitë profesionale dhe integritetin etik e moral.

3. Plotësimi i kritereve të mësipërme vlerësohet në bazë të:

a) vjetërsisë në profesion;

b) përvojës së veçantë të kandidatit në një fushë të caktuar të së drejtës, ose këshilltar ligjor i Gjykatës Kushtetuese a Gjykatës së Lartë;
c) kualifikimeve pasuniversitare dhe trajnimeve në fushën e të drejtës kushtetuese, të drejtave të njeriut ose në një fushë tjetër të së drejtës;

ç) treguesve shkencorë, ku përfshihen botimet dhe artikujt shkencorë në fushën juridike;

d) ecurisë gjatë kryerjes së arsimit të lartë juridik, me një mesatare notash jo më pak se 8 ose të barasvlershme me të, nëse arsimi i lartë është përfunduar jashtë vendit ose vlerësimit përfundimtar në Shkollën e Magjistraturës;

dh) informacioneve të marra nga institucione të tjera publike.

4. Organet e emërtesës marrin parasysh përbërjen e Gjykatës Kushtetuese në momentin e emërimit të kandidatit për të garantuar balancën ndërmjet përvojave profesionale të anëtarëve dhe respektimin e barazisë gjinore.

Kërkesa dhe dokumentet shoqëruese mund të dorëzohen me postë ose drejtpërsëdrejti në ambientet e Presidencës, në adresën: Institucioni i Presidentit të Republikës, Blv. "Dëshmorët e Kombit", Nr. 1 Tiranë, Kodi Postar 1001.

Afati i paraqitjes së kërkesës me dokumentacionin e nevojshëm, është brenda datës 25 mars 2019.

Pas administrimit të dokumentacionit, lista e aplikantëve do të publikohet në faqen zyrtare të internetit të institucionit të Presidentit të Republikës dhe me mjetet e informimit publik, si dhe menjëherë dosjet respektive për secilin aplikant do t'i përcillen Këshillit të Emërimeve në Drejtësi (KED) për vlerësim sipas ligjit.

Institucioni i Presidentit të Republikës, do të bëjë transparent çdo rezultat të këtij procesi në përputhje me Kushtetutën dhe procedurën e parashikuar në nenin 7/"b", të ligjit nr. 8577 datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

Për çdo sqarim mos hezitoni të kontaktoni në këto të dhëna kontakti:

Numri telefonit: 042389898

URDHËR
Nr. 118, datë 28.2.2019

PËR CAKTIMIN E FUSHËS SË VEPRIMTARISË DHE DETYRAVE TË ZËVENDËSMINISTRIT NË MINISTRINË E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave", të nenit 22, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, "Për organizmin dhe funksionimin e administratës shtetërore" dhe të vendimit nr. 505, datë 13.9.2017 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë",

URDHËROJ:

1. Zëvendësministri i Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Z. Kostandin Shkurti, të ndjekë dhe të nënshkruajë, çështjet që kanë të bëjnë me:

a) hartimin dhe zbatimin e politikës shtetërore në fushën e sportit;

b) zbatimin e politikave shtetërore në fushën e edukimit fizik dhe sportit në sistemin arsimor;

c) hartimin, plotësimin dhe përmirësimin e kuadrit ligjor dhe nënligjor për organizimin e zhvillimin e sportit;

d) përmbushjen e objektivave të parashikuara në Planin 300-ditor të Qeverisë, për pjesën që i përket sportit;

e) sigurimin e bashkëpunimit me organizatat sportive dhe Agjencinë e Shërbimit të Sporteve, si institucioni që mbështet aktivitetin e tyre për zhvillimin e sportit në Republikën e Shqipërisë duke respektuar pavarësinë e funksionimit të tyre, administrimin e objekteve sportive publike, që ka në juridiksion;

f) mbështetjen dhe përfshirjen në veprimtari sportive të personave me aftësi të kufizuara dhe integrimin e tyre në jetën shoqërore nëpërmjet sportit;

g) problematikat që parashtrohen nga organizatat sportive në Republikën e Shqipërisë (Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar; federatat sportive; shoqatat sportive; shoqëritë sportive; klubet sportive);

h) monitorimin në vazhdimësi të marrëdhënieve të ndërsjella ndërmjet organizatave sportive dhe institucioneve të pushtetit qendror e vendor;

i) ushtrimin, në mungesë dhe me porosi të ministrit, të kompetencave në fushën e sportit;

j) nxjerrjen e urdhrave për miratimin e statutit apo ndryshimeve statutore të federatave shqiptare dhe Organizatës Kombëtare Antidoping;

k) heqjen e emërtimit "Federatë Shqiptare", në rastet e parashikuara në shkronjat "a", "b" dhe "c", të pikës 3, të nenit 17, të ligjit nr. 79/2017, "Për

sportin";

l) i propozon ministrit pezullimin e dhënies së grandit apo ndryshimin e destinacionit të tij, nëse konstatohet se nuk zbatohen kërkesat e udhëzimit të përbashkët nr. 4, datë 11.3.2014, "Për mënyrën e përdorimit të fondit "Grant/Transfertë korrente e brendshme" për Federatat Sportive dhe Komitetin Olimpik Shqiptar", ose për arsye/shkaqe të tjera të motivuara;

m) mbajtjen e marrëdhënieve me EPAS (organizata evropiane përgjegjëse për politikat e sportit pranë Këshillit të Evropës);

n) monitorimin e analizave antidoping;

o) trajtimin e sportistëve elitarë sipas kërkesave të federatave;

p) miratimin e kërkesës së federatave të një sporti të caktuar për organizimin e veprimtarive zyrtare me karakter ndërkombëtar në Republikën e Shqipërisë;

q) kryesimin në Këshillin e Lartë të Sportit.

2. Zëvendësministri mund të kërkojë informacion me shkrim për çdo korrespondencë shkresore të administratës së Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë për çështjet në fushën e sportit.

3. Ngarkohet zëvendësministri, që brenda 10 ditëve nga miratimi i këtij urdhri, të detajojë planin e punës me veprimet dhe afatet konkrete për përmbushjen e detyrave të përcaktuara më sipër. Plani i punës miratohet nga ministri.

4. Zëvendësministri bashkëpunon dhe koordinon punën me zëvendësministrat e tjerë të Arsimit, Sportit dhe Rinisë për çështje të caktuara, që konvergojnë në fushën e përgjegjësisë dhe veprimtarisë së dy ose më shumë zëvendës-ministrave.

5. Ngarkohet stafi administrativ i ministrisë dhe institucionet e varësisë, që të asistojnë dhe mbështesin zëvendësministrin për përmbushjen e detyrave të ngarkuara.

6. Ngarkohet zëvendësministri, z. Kostandin Shkurti, për zbatimin e këtij urdhri dhe Drejtoria e Miradministrimit të Burimeve Njerëzore, Aseteve dhe Shërbimeve, për njoftimin e urdhrit, drejtorive të ministrisë dhe institucioneve të varësisë së Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT, SPORTIT
DHE RINISË

Besa Shahini

	Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2019

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 196 lekë